

**Njoftim për përqendrim, që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga Telekom
Srbija, Republika e Serbisë, mbi Shoqërinë për shërbime të telekomunikacionit kabllor
KATV SHPK Çoka, Republika e Serbisë
(lënda nr. 08-127 /2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 25.08.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin Telekom Srbija, me seli të regjistruar në rrugën Takovska nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të vetëm mbi Shoqërinë për shërbime të telekomunikacionit kabllor KATV SHPK Çoka, me seli të regjistruar në rrugën Marshalla Tita 22a, Çoka, Republika e Serbisë.

-Telekom Srbija është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikacione kabllore, dhe nga shërbimet që ofron, veçojmë shërbimet e telefonisë fikse e mobile, internetit dhe shërbimet multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Telekom Srbija ka një shoqëri të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve me tela, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjet publik radio-komunikimi, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër operatoresh, shërbime telefonike publike të disponueshme në rrjetin publik të komunikimit celular, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Person i lidhur me MTEL SHPKNJP Shkup është: **Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup**. Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup vepron në tregun për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike celulare (shërbim me parapagesë) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtar shërbim celular me kontratë(postpaid). *Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup* është një operator rrjeti virtual celular (ORRVC) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming. Shërbime me zë, SMS dhe internetit.

Gjithashtu, person i lidhur me Telekom Srbija në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është: **Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup** (“TOTAL TV SHPK Shkup”), me seli në Bulevardin Partizanski odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë - telekomunikacione satelitore.

-Shoqëria për shërbime të telekomunikacionit kabllor KATV SHPK Çoka është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, e regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbime interneti, si dhe shërbime të distribuimit të përmbajtjes së medias.

Shoqëria për shërbime të telekomunikacionit kabllor KATV SHPK Çoka nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.08.2025

Shkup